

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-456/2

18.02.2025

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 45-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 18.02.2025 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10:00.

Seancën në ora 10:00 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Drenuse Dalipi, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Valentina Llazaroska, Bojan Stojkoski, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Sibel Tufkegji, Abdulla Sejdini, Fortesa Sejdini, Ramazan Zulbeari, dhe Nexhbi Dervishi.

Në mungesë ishin këshilltarët : Valbona Adili Emini, Migjen Zendeli dhe Kamerr Klosi.

Të pranishëm në seancë ishin: Aneta Nasteska - sekretare e komunës, Valdet Selimi, Burim Kadriu, Fisnik Fejza dhe Darko Belevski- përfaqësues nga administrata lokale, Drejtori i SHF „Kuzman Josifoski-Pitu,, Kërçovë, Drejtoresha e SHF „Hristo Uzunov,, f.Dërgovë, si dhe gazetarë nga TV „Uskana,,

Kryetari i Këshillit - përshëndeti të pranishmit dhe e vendsoi për miratim Procesverbalin e seancës së 43-të të Këshillit të mbajtur më 26.12. 2024 dhe pyeti nëse dikush kishte ndonjë pyetje.

Valentina Lazareska - Informon se në pikën e 23-të të rendit të ditës në faqen 20 të procesverbalit ka vërejtje lidhur me paraqitjen e saj, përkatësisht: në vend të "temë akute" të lexohet "tema aktuale" për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Më pas, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Procesverbalin e seancës së 43-të të Këshillit të mbajtur më 26.12.2024 dhe i njehti u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim edhe procesverbalin e seancës së 44-të të Këshillit të mbajtur më 23.01.2025 dhe i njehti u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1.Propozim Program për punën e Këshillit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

2. Raporti kuartal i Komunës së Kërçovës për kuartalin e katërt nga 01.01.2024 deri 31.12.2024

3. Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025

4. Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për përcaktimin e vlerës së pikës për rrogat e nëpunësve shtetërorë për vitin 2025

5. Propozim Program për Zhvillim ekonomik lokal (ZHV L) të Komunës së Kërçovës për vitin 2025

6. Propozim Program për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të shquara me monumente përkujtimore në Komunën e Kërçovës për vitet 2025-2029.

7. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të hapsirës Dhomës Ekonomike të RMV-së.

8. Propozim Vendim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal.

9. Propozim ndryshim dhe plotësim i Planit për punësim të SHF”Hristo Uzunov” Dërgovë për vitin 2025

10.Propozim Plani financiar vjetorë për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë

11.Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të PDU-së për lgj.”Podvarosh” NJU “A”, Blok “A12” – pjes 1.

12.Propozim Vendim për hartimin e PU jashtë vedbanimit, me qëllim A 4,3 – vikend shpiza, në PK. Nr.4741, KK Kërçovë jashtë r.n, në vendin e quajtur Karamanica, Komuna e Kërçovës.

13.Të ndryshme.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës të propozuar për këtë seancë dhe i njehti u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kalohet në:

1. PIKA E PARË: Propozim Program për punën e Këshillit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

Valdet Selimi - Informon se ky Program i punës së Këshillit po sillet për herë të parë në Këshill, dhe obligimi për miratimin e tij rrjedh nga neni 36 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe kapitulli i shtatë i Rregullores së Këshillit, përkatësisht neni 138 i Rregullores së Punës. Përmbajtja e programit ishte për dy periudha kohore: periudhën nga Janari në Qershor dhe nga Qershori në Dhjetor. Ai theksoi se nëse dikush ka sugjerime, programi mund të plotësohet.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për punën e Këshillit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025 dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

2. PIKA E DYTË: Raporti kuartal i Komunës së Kërçovës për kuartalin e katërt nga 01.01.2024 deri 31.12.2024.

Burim Kadriu - Informon se Raporti paraqet në detaje realizimin e buxhetit duke përfshirë të hyrat, shpenzimet, borxhet dhe në fund realizimin e programeve. Ai theksoi se realizimi i të hyrave ishte 93% dhe ka pasur një rritje prej 5% nga viti paraprak. Në të ardhurat tatimore realizim 106% ose 12% rritje nga viti i kaluar. Bllok grantet kanë një normë realizimi prej 99%. Shpenzimet kanë një realizim prej 97.4% dhe ka pasur rritje nga viti i kaluar. Më pas shpjegoi në detaje për ato. Realizimi i buxhetit bazë ishte 98%. Lidhur me borxhet e komunës, ai bëri me dije se borxhi ishte për një kredi afatgjatë prej 19 milionë dhe 11 milionë ndaj subjekteve të ndryshme me të cilat komuna kishte lidhur marrëveshje.

Kryetari i Këshillit informoi se Komisioni për Financa dhe Buxhet nuk është mbajtur për shkak të mungesës së kuorumit, pasi vetëm kryetari i Komisionit ka qenë i pranishëm dhe më pas ka dorëzuar për miratim Raporti kuartal i Komunës së Kërçovës për kuartalin e katërt nga 01.01.2024 deri 31.12.2024 dhe i njehti u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

3. PIKA E TRETË: Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

Burim Kadriu - Informoi se vendimi i miratuar në seancën paraprahe ka pasur lëshime të cilat janë vënë në dukje nga Ministria e Financave dhe se është e nevojshme ndryshimi i atij vendimi. Në nenin 9 të atij vendimi, pika 1, alineja 1, fjalët "koeficienti" "3.2" zëvendësohen me "2.47" dhe në nenin 13, pika 1, alineja 1, fjalët "në tre muajt e fundit" zëvendësohen me fjalët "në vitin e fundit".

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025 dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

4. PIKA E KATËRT: Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për përcaktimin e vlerës së pikës për rrogat e nëpunësve shtetërorë për vitin 2025

Burim Kadriu – Njofton se në Vendimin për përcaktimin e vlerës së pikës për pagat e nëpunësve shtetërorë për vitin 2025 e cila u miratua në seancën e kaluar, kishte lëshime në përcaktimin e vlerës së pikës, të cilat ishin vënë në dukje nga ministria dhe kishin nevojë për ndryshim. Kështuqë, në nenin 1 të Vendimit “2024” zëvendësohet me "2025". dhe teksti “rritur me 10% pas Vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave në sektorin publik, i cili vlen nga shtatori 2023”. dhe rritur me 0.7% sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive në Sektorin Publik, fshihet.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për përcaktimin e vlerës së pikës për rrogat e nëpunësve shtetërorë për vitin 2025 dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

5. PIKA E PESTË: Propozim Program për Zhvillim ekonomik lokal (ZHVL) të Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

Darko Beleski - Informon se vitin e kaluar ka pasur një vonesë me programin, andaj edhe kësaj radhe ka qenë i njëjti program dhe është dashur që të bëhet aneks të programit duke shtuar fjali përkatëse për përfaqësimin gjinor.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për Zhvillim ekonomik lokal (ZHVL) të Komunës së Kërçovës për vitin 2025 dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

6. PIKA E GJASHTË: Propozim Program për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të shquara me monumente përkujtimore në Komunën e Kërçovës për vitet 2025-2029.

Valdet Selimi - Informon se kjo pikë është shqyrtuar në komision ndërsa bazë ligjore ky program ka pasur në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Më pas ai shpjegoi programin në detaje duke thënë se programi përbëhet nga dy pjesë, pjesa e parë për mirëmbajtjen e memorialeve ekzistuese dhe pjesa e dytë për ngritjen e monumenteve të reja. Ai theksoi se ajo duhet të miratohet me badinter.

Abdulla Sejдини – Bën me dije se ka pasur një gabim në program lidhur me ngritjen e monumentit të Skënderbeut në “Kale”. Në program duhej të ishte kthimi i atij monumenti atje, sepse ishte ndër monumentet e para që u ngritën aty. Ai ka theksuar se kjo është dashur të përfshihet në programin e miratuar në seancën e kaluar. Programi duhet të kishte kaluar të gjitha filtrat, të ishte aplikuar një badinter dhe ata si këshilltarë të ishin model për qeverisjen e përbashkët për të gjithë. Këtu nuk duhej të kishte ndarje etnike, por më tepër një mesazh se heronjtë tanë nga komuna po përkrahen, ashtu si edhe bustet e Skënderbeut dhe Sulejman Elezit.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të shquara me monumente përkujtimore në Komunën e Kërçovës për vitet 2025-2029 dhe nuk u miratua me 9 vota PËR. 11 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

7. PIKA E SHTATË: Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të hapsirës Dhomës Ekonomike të RMV-së.

Sekretari i Komunës - Informon se në pajtim me Ligjin për shfrytëzimin e sendeve në pronësi publike dhe nenin 50 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komuna pronat në posedim të sajë mund t'i japë në shfrytëzim. Bëhej fjalë për dhënien në përdorim pa dëmshpërblim të një dhome 15m² me 25m² Dhomës Ekonomike, e cila tashmë ishte vendosur aty për një periudhë të caktuar.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të hapsirës Dhomës Ekonomike të RMV-së dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

8. PIKA E TETË: Propozim Vendim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal.

Sekretari i Komunës - Informon se në përputhje me Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe në përputhje me programin ZHEL, është bërë bashkëpunim në mes të disa komunave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Rajonale për Mbeturinat Komunale. Pas marrjes së Vendimit do të formohet një komision për zbatimin e mëtejshëm të procedurës.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal dhe është miratuar me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 5 minutash. Pas pushimit seanca vazhdoi.

9. PIKA E NËNTË: Propozim ndryshim dhe plotësim i Planit për punësim të SHF”Hristo Uzunov” Dërgovë për vitin 2025

Drejtoresha - Informon se për herë të dytë e dorëzon planin e punësimit, i cili tani është korrigjuar, pasi nuk është realizuar punësimi në vendin e punës arkëtar.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim ndryshim dhe plotësim i Planit për punësim të SHF”Hristo Uzunov” Dërgovë për vitin 2025 dhe u miratua me 20 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

10. PIKA E DHJETË: Propozim Planit financiar vjetorë për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë

Drejtori - Informon se Planit Financiar është dorëzuar dhe nëse ka pyetje në lidhje me të është këtu të përgjigjet.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Planit financiar vjetorë për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë dhe u miratua me 11 vota PËR. 3 vota KUNDËR. 5 vota PËRMBAJTUR.

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të PDU-së për lgj.”Podvarosh” NJU “A”, Blok “A12” – pjes 1.

Kryetari i Komisionit - Argjent Asani, lexoi Raportin nga seanca e Komisionit për Veprimtari Komunale Publike, Urbanistikë dhe Mbrojtje të Mjedisit jetësorë dhe propozoi që Vendimet të miratohen.

Fisnik Fejza – Informon se nëse dikush kërkon ndonjë sqarim ai do të sqarojë.

Ivanço Bozhinoski - Informon se ajo pjesë ishte nën mbrojtje monumentale. Ai pyeti se a ishte hequr mbrojtja, a kishte ndonjë dokument për të dhe përderisa egziston një dokument i itllë i njejtë duhej t’ju ishte dorëzuar këshilltarëve.

Fisnik Fejza - bën të ditur se në seancë të Komisionit është shqyrtuar dhe është parë se ai objekt nuk është më nën mbrojtje dhe nëse duan do t'u jepte një dokument për këtë.

Ivanço Bozhinoski - Informon se në qoftëse është hequr mbrojtja, atëherë duhet të dorëzojnë certifikatë pronësie për t'u siguruar, por tani edhe ata e besojnë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të PDU-së për lgj.”Podvarosh” NJU “A”, Blok “A12” – pjes 1 dhe u miratua me 14 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

12. PIKA E DYMBËDHJETË: Propozim Vendim për hartimin e PU jashtë vedbanimit, me qëllim A 4,3 – vikend shpiza, në PK. Nr.4741, KK Kërçovë jashtë r.n, në vendin e quajtur Karamanica, Komuna e Kërçovës.

Fisnik Fejza - bën me dije se parcela nr.4741 ishte jashtë Planit të Përgjithshëm Urbanistik dhe ishte e nevojshme që të përfshihej në plan urbanistik. Bëhej fjalë vetëm për objekt banimi - shtëpi fundjave njëkatëshe.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për hartimin e PU jashtë vedbanimit, me qëllim A 4,3 – vikend shpiza, në PK. Nr.4741, KK Kërçovë jashtë r.n, në vendin e quajtur Karamanica, Komuna e Kërçovës dhe është miratuar me 14 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

13. PIKA E TREMBËDHJETË: Të ndryshme

Kryetari i këshillit lexoi kërkesat e pranuar.

1. Kërkesë nga Shoqata e Prindërve të Fëmijëve me aftësi të kufizuara në zhvillim “Nadezh” nga Kërçova, me vendndodhje në Drugovë, për posedim të përhershëm të objektit të ish Komunës së Drugovës, objekt i cili aktualisht është në renovim nga ana e shoqatës.

Kryetari i këshillit informoi se kërkesa duhet t'i dërgohet shërbimeve kompetente për shqyrtim.

2. Kërkesë për realizimin e kampit veror, 2025

Për të realizuar kampin veror Korpusi i Paqes dhe „Mirko Mileski,, dhe ai të jetë falas për fëmijët e moshës 6-14 vjeç, kërkohet ndihmë financiare nga komuna në vlerë prej 8 mijë dollarë.

Kryetari i Këshillit informoi se kërkesa duhet të dorëzohet në zyrën e kryetarit.

Kryetari i Këshillit bëri me dije se në materialet e seancës është paraqitur edhe raport nga Komisioni i Sportit.

Abdulla Sejдини - Ai e përshëndeti komisionin dhe njoftoi se në atë Raport nuk ka ndarje etnike, Komisioni i Sportit nuk ka bërë shpërndarjen e mjeteve për klubet sipas përkatësisë etnike dhe shpreson se do të vazhdojë të punojë në këtë mënyrë.

Valentina Lazarevska - Informon se nuk është përcjellë kërkesa e banorëve të një objekti banesor në rrugën “Mito Joveski”, nr.5 për zgjidhjen e problemit me nivelimin e pllakave të bekatonit dhe deri ku është realizimi.

Kryetari i këshillit u përgjigj se kjo kërkesë është shqyrtuar në seancën e kaluar dhe është vendosur që të zbatohet.

Pasi që askush nuk e morri fjalën, dhe me këtë rendi i ditës u shterë për këtë seancë, Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 11 e 30 minuata.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.

Përkthyes:Tefik Asani

